



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 786 Prot.

Tiranë, më datë 21.06.2022

VENDIM
Nr. 296, datë 21.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.06.2022:

VENDOSI:

1. Shtyrje e Vendimmarrjes për projektin “*Rijetësimi banesa Hekuran Ali, brenda mureve të Kalasë së Tepelenës*” me aplikues dhe zhvillues Marmo-Graniti sh.p.k;
 - Të rishikohet projekti arkitektonik dhe të jetë në përputhje me kuadrin ligjor aktual;
 - Të përmirësohet trajtimi arkitektonik i objektit;
2. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

KRYETAR
Elva MARGARITI

